



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

**VENDIM**  
**Nr. 74, datë 20.02.2020**

**PËR**  
**KOMANDIMIN NË SKEMËN E DELEGIMIT TË GJYQTARES**  
**ZNJ.{...}**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 61 dhe 97 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 45 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Vendimin e tij nr. 22, datë 07.02.2019, “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e funksionimit të skemës së delegimit të gjyqtarit”, pas shqyrtimit të kërkesës së gjyqtares znj.Mimoza Margjeka, mbi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

**VENDOSI:**

1. Pranimin e kërkesës së gjyqtares znj.{...}.
2. Komandimin e gjyqtares znj.{...} në skemën e delegimit të ngritur pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, për një afat 2-vjeçar.
3. Përfshirjen e gjyqtares znj.{...} nga procedurat e shortit pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.
4. Gjyqtarja e skemës së delegimit, znj.{...}, ngarkohet të përfundojë të gjitha çështjet që ka në shqyrtim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës.
5. Efektet juridike të vendimit fillojnë data e njoftimit.
6. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares znj.{...} sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në adresën postare elektronike zyrtare, si dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**